

## **Fushata “Mësimi dual: Mundësi për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve”**

Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) është një aspekt thelbësor i arsimit që u siguron individëve aftësitë dhe njohuritë praktike, të nevojshme për fuqinë punëtore. Megjithatë, AAP-ja shpesh është anashkaluar, duke çuar në një perceptim negativ në mesin e publikut.

Sistemit kosovar të AAP-së i mungon orientimi drejt tregut të punës në shumë fusha dhe për rrjedhojë, nxënësit nuk pajisen me aftësitë e nevojshme për t’iu përshtatur nevojave të tregut të punës. Punëdhënësit shpesh ankohen për mungesën e punësueshmërisë, ndërsa të diplomuarit kanë vështirësi për të gjetur punë.

Pasojat e perceptimit negativ të AAP-së mund të jenë të thella. Kjo përfshin mënyrën se si qeveria, industria, kompanitë dhe komuniteti e shohin, mbështesin dhe angazhohen me AAP-në.

Përveç kësaj, këto perceptime mund ta formësojnë gjithashtu gatishmërinë e kompanive (si punëdhënës të mundshëm) për tu angazhuar dhe marrë pjesë në sistemin publik të AAP-së, duke ju ofruar nxënësve të shkollave profesionale, mundësinë për të bërë praktikën, qoftë përmes mësimit në vendin e punës apo mësimit dual.

Ekziston gjithashtu një shqetësim aktual dhe në rritje, se të rinjtë gjithnjë e më shumë preferojnë të ndjekin arsimin e lartë, që nuk ka rezultate të drejtpërdrejta punësimi. AAP-ja, në rastin më të mirë, shihet si një zgjedhje e dytë ose jo e preferuar.

Pra, perceptimet apo imazhi i AAP-së formëson edhe mënyrën se si të rinjtë zgjedhin profesionet e tyre dhe se si, prindërit dhe mësuesit këshillojnë për rrugëtimet e këtyre të rinjve drejt studimeve të mëtejshme ose jetës së punës.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), është duke punuar në drejtim të harmonizimit të AAP-së me nevojat e tregut të punës, përmes implementimit të mësimit dual që për rrjedhojë, do ta bëjë AAP-në më relevante. Përmirësimet në sistemin e AAP-së duhet të shkojnë paralelisht me ndryshimin e perceptimit të imazhit të AAP-së, i cili për shumë vite ka qenë mjaft negativ.

Fushata e AAP-së, e udhëhequr nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit,

me mbështetjen e Qeverisë së Gjermanisë dhe donatorëve të tjerë, synon të kontribuojë në ndryshimin e këtij perceptimi, si dhe të nxjerr në pah rëndësinë e AAP-së në shoqëri, dhe ndikimin që e ka në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit.

Objektivat e fushatës janë:

1. Të përmirësohet perceptimi i përgjithshëm i AAP;
2. Të nxisë një kuptim të përbashkët të publikut mbi rolin kryesor që një sistem i zhvilluar mirë i AAP-së ka në krijimin e fuqisë punëtore të kualifikuar, që harmonizohet me kërkesat e tregut të punës;
3. Të promovojë në mënyrë aktive përfitimet e AAP-së dhe mësimit dual dhe të inkurajoj të rinjtë të shohin arsimin profesional si një alternativë të mirë dhe të qëndrueshme për karrierën e tyre.

Audienca e synuar:

Fushata për imazhin e AAP-së synon ta arrijë publikun, me fokus të veçantë në katër grupet:

- Kompanitë, si ofrues të punës praktike në kuadër të mësimit dual dhe si punëdhënës potencial për nxënësit e shkollave profesionale;
- Nxënësit e shkollave të mesme të ulëta (fokusi te nxënësit e klasave të 9-ta), por edhe nxënësit e klasave 10-11 që vijojnë mësimin dual;
- Mësimdhënësit dhe këshilltarët e karrierës, të cilë kanë ndikim në orientimin e nxënësve në karrierën e tyre
- Prindërit, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm, në përzgjedhjen që fëmijët e tyre bëjnë për të ardhmen e tyre.